



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS I AVOKATIT TË POPULLIT

PËR

VIZITËN NË QENDRËN E MBAJTJES PËR TË HUAJT NË VRANIDOLL

Për: Z. Xhelal Sveçla, ministër
Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike

Kopje: Z. Ismet Krasniqi, sekretar i përgjithshëm
Kuvendi i Republikës së Kosovës

Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Z. Liridon Neziri, ushtrues detyre i drejtorit
Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion

Z. Selman Nimanaj, drejtor
Qendra e Mbajtjes për të Huajt

Prishtinë, më 25 korrik 2022

1. Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të torturës (MKP), bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë këtu edhe vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, qëndrimi i të cilëve në Republikën e Kosovës bie ndesh me ligjet në fuqi dhe të cilët janë subjekt i kthimit me forcë nga Republika e Kosovës.
2. Bazuar në këtë mandat, MKP-ja më 19 maj dhe më 30 qershor 2022 ka vizituar Qendrën e Mbajtjes për të Huajt (QMH). QMH-ja funksionon në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DShAM) i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Sipas nenit 2 të Rregullores (MPB) nr. 04/2018 për Funksionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve (në tekstin e mëtejme: Rregullorja), në këtë qendër vendosen të huajt të cilët janë subjekt i largimit me forcë, si dhe të huajt për të cilët konsiderohet se e cenojnë sigurinë publike, me qëllim të vërtetimit të identitetit të tyre dhe për arsye të tjera. Kapaciteti i QMH-së është për 70 persona, ndërsa gjatë vizitës së bërë nga MKP-ja ishin të pranishëm 3 të huajt.

Qëllimi i vizitës

3. Qëllimi i kësaj vizite ishte monitorimi i respektimit të të drejtave të të huajve që mbahen në QMH, të cilat parashihen me Ligjin nr. 04/L-219 për të Huajt, me Ligjin për Azil, me Rregulloren nr. 04/2018 për Funksionimin e Qendrës së Mbajtjes për të Huajt, dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe kufizimi i tyre për shkak të paraqitjes së pandemisë COVID-19. Po ashtu, gjatë vizitës u trajtua çështja e personelit të QMH-së dhe personelit të sigurisë, trajnimet dhe përgatitja adekuate e tyre për të punuar me këtë kategori etj.

Përbërja e ekipit monitorues

4. Grupi monitorues përbëhej: një këshilltar i lartë juridik për parandalim të torturës dhe një psikologe këshilltare nga MKP-ja, personeli i Komisarariatit të Lartë për Refugjatë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNHCR) dhe personeli i Civil Rights Program Kosovo (CRPK). Kjo vizitë e përbashkët u realizua bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet organizatave të lartpërmendura dhe Institucionit të Avokatit të Popullit.

Bashkëpunimi i personelit të QMH-së me Grupin Monitorues gjatë vizitës

5. Gjatë vizitës në QMH, personeli i kësaj qendre i ka ofruar Grupit Monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat e QMH-së. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe iu mundësua intervistimi i personave që gjendeshin në mbajtje, pa praninë e zyrtarëve të sigurimit dhe zyrtarëve të tjerë të QMH-së.

Paraburgimi i të huajve si masë e fundit

6. Në pikëpanjën e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, paraburgimi (dërgimi i të huajit në mbajtje) duhet të jetë masa e fundit të cilën e zbatojnë autoritetet e një shteti për ta larguar të huajin nga territori, i cili është subjekt i kthimit me forcë.

7. MKP-ja vëren se Ligji 04/L-219 për të Huajt i Republikës së Kosovës parasheh se masat e tjera alternative kanë përparësi në raport me dërgimin e të huajit në mbajtje.¹ Po ashtu, Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT), në standardet e përcaktuara në vitin 2017, përcakton se paraburgimi i të huajit sipas ligjit për të huajt duhet të jetë masë e fundit dhe se masave të tjera alternative duhet t'u jepet epërsi.²

Garancitë procedurale gjatë paraburgimit dhe njoftimi për të drejtat

8. Neni 8 i Rregullores përcakton se pranimi në QMH bëhet bazuar në urdhrin për ndalimin e të huajit në QMH, i cili nxirret nga DMH-ja. Me rastin e dorëzimit të të huajit në QMH, DMH-ja duhet të dorëzojë: urdhrin për ndalim në QMH, urdhrin për largim me forcë, si dhe urdhrin për largim vullnetar, nëse është nxjerrë, raportin e zyrtarit policor, duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikshmërisë, vërtetimin për dokumentet dhe gjësendet e sekuestruara, si dhe dokumentet dhe gjësendet e sekuestruara.
9. Më tej, sipas Rregullores, QMH-ja e konfirmon pranimin e të huajit në këtë qendër përmes fletëpranimit³. Bazuar në dosjet e të huajve të pranishëm, MKP-ja vëren se nga autoritetet janë respektuar kriteret e lartpërmendura të përcaktuara në Rregullore.
10. MKP-ja vëren se standardet e përcaktuara nga KPT-ja përcaktojnë shprehimisht se të gjithë të huajt e paraburgosur si emigrantë të parregullt, që nga momenti i privimit nga liria, duhet t'i gëzojnë tri të drejta themelore në të njëjtën mënyrë siç i gëzojnë edhe kategoritë e tjera të personave të privuar nga liria. Këto të drejta janë: *të kenë qasje tek avokati mbrojtës, të kenë qasje tek mjeku dhe ta kenë mundësinë t'i njoftojnë të afërmit e tyre apo palën e tretë, sipas përzgjedhjes së tyre, për faktin se janë paraburgosur.*⁴
11. Bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt në Republikën e Kosovës, i huaji i cili vendoset në QMH njoftohet në formë të shkruar, në njërën nga gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze, për ndalimin në këtë qendër, që përmban arsyen e ndalimit, afatet e ndalimit, të drejtën për sigurimin e mbrojtjes së tij ligjore, si dhe të kontaktojë me të afërmit e vet.⁵
12. Sipas Rregullores, i huaji i vendosur në këtë QMH ka të drejtat në vijim: *informimi lidhur me të drejtën e ankimit për ndalimin në Qendër, të drejtën lidhur me ndihmën juridike falas, të drejtën për përkthyesin në gjuhën e tij ose në një gjuhë të cilën ai/ajo e kupton, të drejtën për të komunikuar me organet dhe organizatat relevante vendore apo ndërkombëtare, si dhe me organizatat joqeveritare.*⁶
13. MKP-ja gjatë vizitës ka vërejtur se të huajt në QMH informohen për të drejtat e tyre përmes broshurave të shkruara në gjuhët më të shpeshta dhe në gjuhën arabe. Përveç kësaj, ata njoftohen për të drejtat e tyre nga përkthyesi i gjuhës arabe, i cili është angazhuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM). MKP-ja ka vërejtur në

¹ Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt, neni 97, paragrafi 2.

² KPT, Standardet e publikuara në mars të vitit 2017 për paraburgimin e të huajve. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

³ Neni 8, paragrafi 3, i Rregullores.

⁴ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 19-të i Përgjithshëm i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, paragrafi 81, në: <http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%7B%22CPTSectionID%22:%7B%22p-standards-inf-2009-27-part-en-3%22%7D%7D>.

⁵ Ligji 04/L-219 për të Huajt, neni 108.

⁶ Neni 11 i Rregullores, Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

dosjen e të huajve deklaraten (në cilësi të dokumentit zyrtar), e cila është e shkruar në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht, ku të huajt e ndaluar deklarojnë se janë njoftuar për të drejtën e tyre.

14. Sa i përket së drejtës së të huajit për ta kontaktuar konsullatën apo ambasadën e shtetit, MKP-ja vëren se Ligji për të Huajt përcakton të drejtën e të huajit për ta njoftuar përfaqësuesin diplomatik apo konsullor lidhur me ndalimin e tij.⁷ Po ashtu KPT-ja në Raportin e 19-të të Përgjithshëm përcakton të drejtën e të paraburgosurit të huaj për të kontaktuar konsullatën e vendit nga i cili është dhe e konsideron si një të drejtë themelore.⁸ MKP-ja nuk mori ankesa nga të huajt lidhur me të drejtat e lartpërmendura.

Trajtimi

15. Gjatë vizitës së realizuar nga MKP-ja në QMH, ishin të pranishëm 3 persona të huaj të ndaluar. MKP-ja ka kontrolluar dosjet e tyre dhe ka realizuar intervista grupore përmes përkthyesit të gjuhës arabe. MKP-ja nuk ka marrë asnjë ankesë nga personat e intervistuar për keqtrajtim fizik, përdorim të tepruar të forcës fizike apo për sjellje nga zyrtarët e sigurisë dhe zyrtarët e QMH-së, gjë që nuk do të ishte në pajtim me respektimin e dinjitetit të tyre. Përkundrazi, të huajt në ndalim u shprehën në favor të një trajtimi shumë të mirë nga Policia e Kosovës dhe nga zyrtarët e MPB-së.
16. Ekipi i MKP në vizitën e realizuar më 30 qershor 2022 në QMH ka vizituar të huajin E.T., i cili ishte i akomoduar në QMH së bashku me djalin e tij, O.T. Gjatë vizitës MKP-ja ka intervistuar E.T., i cili nuk kishte ankesa sa i përket kushteve dhe trajtimit në QMH. Ankuesi shprehu shqetësimin se djali tij, O.T., gjatë qëndrimit në Qendrën e Azilit është bullizuar nga një banor tjetër në atë qendër.
17. Po ashtu ankuesi ka thënë se djali i tij ishte arrestuar nga PK-ja dhe gjatë arrestimit dhe mbajtjes së paraburgimit ai pretendon se djali i tij është keqtrajtuar nga PK-ja dhe nga zyrtarët korrektuese. Ai ka thënë se gjatë kohës sa djali i tij ka qenë në paraburgimin për dy javë në Qendrën Korrektuese për të Mitur, nuk ka pasur mundësi ta vizitonte e as të kishte informacion lidhur me gjendjen e tij shëndetësore.⁹
18. MKP-ja ka shqyrtuar dokumentacionin për rastin O.T., përfshirë dosjen shëndetësore, raportin e policisë dhe vendimet e gjykatës. Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, MKP-ja nuk ka vërejtur shenja të keqtrajtimit fizik. Po ashtu, MKP-ja ka kontaktuar edhe avokaten e autorizuar, që e ka përfaqësuar palën në gjykatë, e cila ka pohuar se gjatë gjithë mbrojtjes në gjykatë, pala nuk ka shprehur shqetësim për keqtrajtim dhe nuk janë vërejtur shenja të keqtrajtimit fizik.
19. Bazuar në vendimin e gjykatës, Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, të miturit O.T. i është shqiptuar Masa e Trajtimit të Detyrueshëm Psikiatrik në Liri. Stafi i QMH-së të miturin O.T. e ka dërguar në Qendrën e Shëndetit Mendor në Prishtinë duke iu përmbajtur aktvendimit të gjykatës.
20. Lidhur me rastin, udhëheqësi i QMH-së ka shprehur shqetësimin se në mungesë të infermierit në qendër, terapia psikiatrike i është dhënë nga stafi i QMH-së. Ndërsa sa i

⁷ Ligji 04/L-219 për të Huajt, neni 114, paragrafi 3.

⁸ Për më shumë shih në: <http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%7B%22CPTSectionID%22:%5B%22p-standards-inf-2009-27-part-en-3%22%5D%7D>.

⁹ Rasti A.nr.362/2022, O.T. kundër MPB-së, në hetim e sipër nga MKP-ja.

përket dosjes mjekësore, vërehet se të gjitha shërbimet shëndetësore i janë dhënë përmes Qendrës së Mjekësisë Urgjente të Prishtinës. Po ashtu në shkresat e lëndës ishte edhe vendimi me të cilin ankuesi vullnetarisht do të kthehet në vendin e origjinës përmes organizatës IOM.

Incidentet në QMH

21. Në Raportin me rekomandime, i publikuar në 2019,¹⁰ MKP-ja ka rekomanduar: “*QMH-ja duhet të mbajë protokollet si në vijim: protokollet për vetminë, tentim vetëvrasje, abuzim seksual dhe të rasteve të vdekjeve.*” Gjatë vizitës nga MKP-ja është vërejtur se rekomandimi në fjalë është zbatuar, udhëheqësi kishte krijuar regjistrat sipas rekomandimit të MKP-së. Në regjistrin e tentim vetëvrasjeve, nga janari i vitit 2022 e deri në kohën e vizitës, nuk ka vërejtur asnjë incident apo ndonjë rast të vetëlëndimeve. MKP-ja gjithashtu ka vërejtur se gjatë 2022-ës kishte ndodhur një rast vdekjeje në spital nga COVID-19.

Ndihma juridike falas

22. Sipas nenit 29 të Rregullores, të huajt i ofrohet këshillimi, përfaqësimi juridik dhe, kur është e nevojshme, ndihma gjyqësore. MKP-ja ka vërejtur se të huajve në mbajtje ndihma juridike falas u ofrohet nga organizata joqeveritare CRPK.

Kushtet materiale

23. MKP-ja konsideron se kushtet e akomodimit në QMH janë në nivel shumë të mirë. Të gjitha dhomat ofronin akomodim të denjë, ngrohje, ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial, si dhe dushe të cilat ishin në gjendje shumë të mirë. Të huajt në QMH mund të kenë qasje në dushe sa herë që ata duan.

24. MKP-ja ka vërejtur se korridoret e QMH-së mbulohen nga kamerat e sigurisë, të cilat janë garanci shtesë kundër keqtrajtimit fizik, si dhe mbrojtje për personelin nga akuzat e rrejshme. Megjithatë, gjatë vizitës në QMH, MKP-ja është njoftuar nga policia, të cilët qëndrojnë sigurim në këtë qendër, se kamera te hyrja kryesore nuk vërehet qartë, sidomos natën humb pamja e kamerës. MKP-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet të ndër marrin veprime konkrete për t'i evituar mangësitë sa u përket kamerave në përgjithësi.

Ushqimi

25. Të gjithë të huajve u sigurohen tri shujta ditore. Rregullorja parasheh që të huajve në QMH u shërbehet ushqim i posaçëm për shkaqe shëndetësore dhe për nevoja të veçanta. Po ashtu, sipas Rregullores, të huajve u shërbehet edhe ushqim sipas rekomandimit të mjekut.

26. Nëse feja e të huajt parasheh rregulla lidhur me ushqimin, udhëheqësi i QMH-së garanton respektimin e tyre.¹¹ Sipas drejtorit, MPB-ja ka kontraktuar një kompani, e cila furnizon QMH-në me ushqim. Gjatë vizitës së fundit, MKP-ja nuk ka marrë ankesa për ushqimin nga udhëheqësi i QMH-së dhe as nga të huajt e pranishëm.

¹⁰ Raporti me Rekomandime për QMH, shih linkun: <https://www.oik-rks.org/2019/05/03/raport-lidhur-me-viziten-e-mkpt-ne-vranidoll/>.

¹¹ Neni 36 i Rregullores.

Regjimi

27. Neni 24, paragrafi 1, i Rregullores përcakton se çdo i huaj i ndaluar në QMH ka të drejtë për ajrosje së paku dy orë në ditë në mjediset e jashtme të kësaj qendre. Për arsye shëndetësore, udhëheqësi i QMH-së mund ta zgjasë kohën e ajrimit.
28. KPT-ja, në standardet e përcaktuara në mars të vitit 2017 për paraburgimin e të huajve për shkak të imigracionit, thekson rëndësinë e një regjimi, i cili përmban sa më shumë aktivitete. Sipas KPT-së, sa më e gjatë që është periudha e mbajtjes së të huajve, po aq duhet të zhvillohen aktivitetet që u ofrohen atyre.
29. MKP-ja gjatë vizitës ka vërejtur se IOM-i po e mbështet QMH-në me trajnerë për sport, tri herë në javë, me mjete sporti, si: top futbollit dhe basketbolli, tabela dhe rrjeta ping-pongu, fanella sportive dhe kjo po ndikon pozitivisht në gjendjen emocionale të të huajve të pranishëm aty.

Personeli i Qendrës për Mbajtjen e të Huajve

30. Grupi Monitorues ka vërejtur se QMH-ja vazhdon të përballet me mungesë të personelit. QMH-ja kishte në dispozicion vetëm drejtorin e kësaj qendre dhe një zyrtar për migracion.
31. Gjatë vizitave të MKP-së është vërejtur se detyrat e sigurisë në QMH kryheshin nga njësia e Policisë së Kosovës për siguri, të cilët nuk janë të trajnuar për të punuar me persona të huaj të privuar nga liria.
32. Në këtë drejtim MKP-ja ka vërejtur se standardet e KPT-së përcaktojnë se personeli i sigurisë në qendrat e mbajtjes për të huajt duhet të përzgjidhet me kujdes dhe të ketë trajnime të duhura për të punuar me këtë kategori.¹²
33. Përmes raportit me rekomandime për vizitën në QMH, i publikuar më 13 prill 2021, MKP-ja e Avokatit të Popullit i kishte rekomanduar MPB-së që personeli i sigurisë në QMH duhej t'i nënshtrohej trajnimeve adekuate për të punuar me këtë kategori.

Përdorimi i forcës fizike nga shërbimi i sigurimit

34. Sipas Rregullores, shërbimi i sigurimit mund ta përdorë forcën vetëm si mjet të fundit, nëse kjo është e nevojshme për vetëmbrojtje, për mbrojtjen dhe sigurinë e të huajit ose për mbrojtjen e rendit të përgjithshëm dhe të sigurisë brenda QMH-së. Përdorimi i forcës duhet të jetë i ligjshëm, proporcional dhe i arsyeshëm për qëllimet e nevojshme.¹³ Po ashtu, Rregullorja përcakton se çdo rast i përdorimit të forcës fizike duhet t'i raportohet udhëheqësit të QMH-së.¹⁴
35. Gjatë vizitës, MKP-ja ka vërejtur se zyrtarët policorë kryenin detyra të sigurimit në QMH, kurse për çdo rast që ka nevojë për intervenim, ata ftojnë Stacionin Policorë Veri në Prishtinë. Nga janari 2022 e deri në ditën e vizitës së fundit, MKP-ja nuk ka vërejtur asnjë rast ku është përdorur forca fizike nga shërbimi i sigurimit.

¹²Standardet e KPT-së për paraburgimin e të huajve, publikuar në vitin 2017, shih në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

¹³ Neni 21, paragrafi 1, i Rregullores.

¹⁴ Neni 21, paragrafi 2, i Rregullores.

Kujdesi shëndetësor

36. Sa u përket shërbimeve shëndetësore, Ligji 04/L-219 për të Huajt përcakton se QMH-ja duhet t'i plotësojë të gjitha kushtet e një trajtimi njerëzor si dhe respektimin e të drejtave njerëzore, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe të mundësojë ofrimin e shërbimeve shëndetësore.¹⁵
37. Më tej Rregullorja përcakton se i huaji, gjatë qëndrimit në QMH, ka të drejtë për shërbime mjekësore. Sipas Rregullores, personeli mjekësor kryen ekzaminimin e përgjithshëm mjekësor të të huajit, i cili ndalohet në QMH.¹⁶
38. Të huajve që mbahen në QMH, shërbimet mjekësore u jepen nga Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, sipas nevojës, dërgohen për shërbime spitalore regjionale dytësore apo edhe në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), ku u ofrohen edhe shërbimet shëndetësore terciare, pasi QMH-ja ende nuk ka personel mjekësor, edhe pse MKP-ja, përmes raporteve të mëhershme, kishte rekomanduar që QMH-ja ta ketë në dispozicion së paku një infermier/e. Grupi Monitorues gjatë vizitës së fundit ka vërejtur në dosje se për një rast vështirë të menaxhueshëm, IOM-i i ka ndihmuar me një infermier vetëm për atë rast.
39. Sa u përket shërbimeve psikologjike, të cilat parashihen me nenin 41 të Rregullores, MKP-ja ka vërejtur se ato ofrohen nga psikologu i kontraktuar nga IOM-i.

Rëndësia e kontrolleve mjekësore fillestare

40. Lidhur me rëndësinë e kontrolleve fillestare mjekësore, KPT-ja përcakton: *“Së paku një person me kualifikim të infermierit duhet të jetë i pranishëm në baza ditore në të gjitha qendrat për imigrantët e parregullte. Një person i tillë do të duhej që të kryente skrinimin fillestar mjekësor të të sapo pranuarve (në veçanti për sëmundje të transmetueshme, përfshirë tuberkulozin), të pranojë kërkesat për t'u kontrolluar tek mjeku, të garantojë sigurimin dhe distribuimin e medikamenteve, të mbajë dokumentacionin mjekësor dhe t'i mbikëqyrë kushtet e përgjithshme higjienike.”*¹⁷
41. Rregullorja përcakton se pas vendosjes së të huajit në QMH, në afat brenda 24 orësh, i huaji dërgohet për ekzaminim mjekësor në QKUK (apo në ndonjë institucion tjetër shëndetësor), nën përcjelljen nga Policia (nga DMH-ja). Grupi Monitorues ka vërejtur se këto kontrolle fillestare të huajve në mbajtje u bëhen nga shërbimet e emergjencës.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore në QMH

42. Rregullorja parasheh se të gjitha konstatimet mjekësore duhet të ruhen në dosjen e të huajit dhe në Sistemin për Menaxhimin e të Dhënave. Kartela mjekësore mbahet në mënyrë konfidenciale dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
43. KPT-ja, në standardet e përcaktuara për paraburgimin për shkak të imigrimit, përcakton: *“Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore duhet të respektohet njësojë si në komunitet dhe në veçanti dosjet mjekësore të imigrantëve të parregullt, nuk duhet të jenë të qasshme për personelin jo mjekësor, përkundrazi, ato duhet të mbahen të mbyllura nga infermierja*

¹⁵ Ligji 04/L-219 për të Huajt, neni 107, paragrafi 2.

¹⁶ Neni 13 i Rregullores.

¹⁷ Po aty.

apo mjeku. Për më shumë, të gjitha ekzaminimet mjekësore duhet të kryhen në atë mënyrë, që të mos shihen dhe dëgjohen nga personeli i sigurisë, përveç në rast se mjeku kërkon ndryshe në raste të veçanta.”¹⁸ Grupi Monitorues ka vërejtur se raportet shëndetësore, për shkak të mungesës së personelit të kualifikuar, mbahen së bashku me dosjen e përgjithshme të të huajit. Dosja mbahet në formë elektronike dhe fizike.

Masat disiplinore

44. Sipas Rregullores, masat disiplinore që mund t’i shqiptohen të huajit, janë: vërejtja me gojë apo me shkrim, detyrimi për mirëmbajtjen dhe pastrimin e QMH-së, heqja e së drejtës për aktivitete të lira, për rekreacion, për televizor, për internet, heqja e së drejtës për aktivitete kulturore dhe sportive në kohëzgjatje deri në 5 ditë dhe izolimi deri në 48 orë.¹⁹
45. MKP-ja ka vërejtur se Rregullorja e tanishme, për dallim nga Rregullorja e mëparshme, parasheh se vendimi për shqiptimin e masës disiplinore duhet t’i dorëzohet edhe të huajit, të cilit i shqiptohet masa.²⁰ Bazuar në këtë, MKP-ja gjatë vizitave të mëhershme i ka rekomanduar QMH-së që të evidentohet fakti i dorëzimit të kopjes së vendimit për masë disiplinore dorëzuar të huajit në mbajtje. Gjatë vizitës së fundit, Grupi Monitorues ka vërejtur se QMH-ja ka protokoll të veçantë në të cilin evidentohen të dhëna lidhur me këtë masë disiplinore dhe gjatë vizitës së fundit MKP-ja nuk ka vërejtur asnjë rast që i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore. Po ashtu, MKP-ja ka vërejtur se nga janari deri më 30 qershor 2022 nuk është shqiptuar asnjëherë masa disiplinore e vendosjes në dhoma të veçanta në periudhë prej 48 orëve.

Monitorimi dhe mekanizmat e ankimit

46. Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garanci themelore kundër keqtrajtimit në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria. MKP-ja konsideron se personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda QMH-së dhe, në mënyrë konfidenciale, t’u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.
47. Neni 19 i Rregullores përcakton se të huajt kanë të drejtë ankese tek udhëheqësi i QMH-së, lidhur me kushtet e pranimit në QMH dhe sjelljet e personelit. Ankesa shqyrtohet nga DShAM-ja. Më tej Rregullorja përcakton se në QMH vendoset kutia e ankesave, e cila administrohet nga QMH-ja. Sipas drejtorit, të huajt, përmes broshurave në gjuhë të ndryshme, njoftohen menjëherë për të drejtën e tyre për të parashtruar ankesë.
48. Sa i përket monitorimit, përveç MKP-së, të huajt në QMH mund të vizitohen në çdo kohë nga UNHCR-ja, IOM-i, KPT-ja, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar. Rregullorja parasheh se udhëheqësi i kësaj qendre mund t’u japë të drejtë qasjeje në QMH edhe institucioneve apo organizatave të tjera relevante.²¹ Po ashtu të huajt në mbajtje mund t’i drejtojnë ankesat e tyre tek Avokati i Popullit. Gjatë vizitës, MKP-ja u ka shpërndarë të huajve në mbajtje broshura në gjuhën angleze, serbe, turke dhe arabe, të cilat përmbajnë hollësi se si ata mund të kontaktojnë me Avokatin e Popullit dhe t’i parashtrajnë ankesat e tyre.

¹⁸ Shih në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

¹⁹ Neni 44 i Rregullores.

²⁰ Neni 44, paragrafi 3, i Rregullores.

²¹ Neni 27 i Rregullores.

Kontakti me botën e jashtme

49. Sipas standardeve të KPT-së, të ndaluarit e huaj duhet të kenë çdo mundësi për të qenë në kontakt të mirëfilltë me botën e jashtme (përfshirë mundësitë për të bërë telefonata dhe për të pranuar vizita) dhe liria e tyre e lëvizjes brenda QMH-së duhet të kufizohet sa më pak që të jetë e mundur.²² Sipas nenit 25 të Rregullores, i huaji në mbajtje ka të drejtë të mbajë korrespondencë, të pranojë pako dhe sende të tjera. Po ashtu, të huajve në mbajtje u lejohet të pranojnë vizita.²³
50. Rregullorja përcakton se i huaji ka të drejtë të bëjë telefonata sipas nevojës në kohëzgjatje prej 5 minutash, duke filluar nga ora 9:00 deri në orën 16:00, çdo ditë pune.²⁴ Sipas Rregullores, të huajve u mundësohen edhe thirrjet nga jashtë. Gjatë vizitës, Grupi Monitorues ka vërejtur se të huajt mund t'u telefononin familjeve të tyre. Grupi Monitorues konsideron se, meqenëse është fjala për paraburgim administrativ dhe për paraburgim, në kuptim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të ndaluarve duhet t'u ofrohen edhe mundësi të tjera për komunikim me botën e jashtme, siç janë: komunikimet *online* përmes SKYPE apo edhe përmes sistemeve të tjera të komunikimit.
51. MKP-ja konsideron se të huajve në QMH duhet t'u shtohen edhe të drejta të tjera, pasi ky është një paraburgim administrativ dhe jo paraburgim klasik sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë drejtim është e rëndësishme të jepen më shumë të drejta sa u përket kontakteve me botën e jashtme dhe qasja në internet, por edhe në aktivitetet e tjera jashtë dhomave të tyre.
52. Prandaj, bazuar në të gjeturat gjatë vizitës së Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të torturës, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike:

- **MKP-ja ripërsërit rekomandimin se QMH-ja duhet të ketë në dispozicion së paku një infermier, i cila do ta shpërndante terapinë dhe do të kujdesej për dosjet mjekësore të të huajve në QMH.**
- **Të rritet numri i personelit sipas vlerësimit të nevojave.**
- **Të evitohen mangësitë sa i përket funksionimit të kamerave të sigurisë.**
- **Të huajve të ndaluar t'u mundësohet komunikimi online me familjet e tyre.**


Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr.

²² Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, shih në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

²³ Neni 27 i Rregullores.

²⁴ Neni 26 i Rregullores.

05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.


Me nderime,
Naïm Qelaj
Avokat i Popullit